



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dostiguar Prilbheno/Prilobeno Received/Deftvety	27.03.2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org. Unit	No Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHICK 3032/2023			1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.385/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë me Rushit Kajtazi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.385/2023 të datës 21.02.2023 të parashtruar nga ankuesja [redacted] me adresë banimi rruga „ Bedri Gjinaj”, nga Komuna e Mitrovicës së Jugut, kundër organit të punësimit Komuna e Mitrovicës së Jugut, në çështjen juridike “Kërkesë nga Marrëdhënia e Punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 27.03.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.385/2023 të datës 21.02.2023 të parashtruar nga ankuesja [redacted]

A r s y e t i m

Nëpunësja civile [redacted] e punësuar në Komunën e Mitrovicës së Jugut, përmes Postës së Kosovës, me datë 16.03.2023 ka parashtruar ankesë Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër protokollit 1955/2023, e cila ankesë në Këshill është pranuar me datë 21.02.2023, kundër mos përgjigjes nga organi i punësimit Komuna e Mitrovicës së Jugut lidhur me kërkesën e ankuesit për kompensimin e mjeteve financiare në mënyrë retroaktive nga data 23.04.2013 kur e ka nënshkruar Akt Emërimin e deri me datë 03.12.2022, konkretisht diferencës së dy koeficientëve të pagës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, komfor dispozitave Rregullore Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 28.02.2023 me numër protokollit 2195/2023

ankesën e ankuesit e ka dërguar për përgjigje në ankesë në Komunën e Mitrovicës së Jugut. Ndërsa Këshilli më datë 23.04.2023 me numër protokollit 2703/2023 përmes e-mailit ka pranuar përgjigjen në ankesë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me nr. protokollit 1955/2023 të datës 21.02.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Kërkesë e datës 15.02.2023; Përgjigje në kërkesë e datës 16.02.2023; Vendimi A. Nr. 869/2022, i datës 21.11.2022, i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ndryshimi dhe Plotësimi i Akt Emërimi i datës 30.12.2022; Akt Emërimi i datës 01.05.2013; Përshkrime i Detyrave të Punës; Lista e pagave nga data 01.01.2023, deri me datën 31.01.2023; Përgjigje në kërkesë e datës 16.02.2023; Kërkesë e datës 15.02.2023; Përgjigje në ankesë e datës 15.03.2023, me numër protokollit 2703/2023.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ankesa e ankueses *është e pa bazuar, sepse:*

Kolegji i Këshillit nga provat e administruara të lëndës ka konstatuar se ankuesja është e punësuar në Komunën e Mitrovicës së Jugut në pozitën e punës "Inspektore e Shërbimeve Publike". E njëjta me datë 21.02.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për kompensimin e pagës respektivisht diferencën e koeficientit nga gjashtë (6) në tetë (8), sepse sipas Akt Emërimit të datës 23.04.2013 ankuesja e kishte koeficientin gjashtë (6), ndërsa bazuar në shkresën e DASHC/MAP-04/157102 ZSP/3851 të datës 20.11.2014 thekson faktin se pozita të cilën mbanë duhet të harmonizohet dhe të paguhet me koeficientin tetë (8). Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me Vendimin A.nr. 869/2022 të datës 21.11.2022 ka aprovuar ankesën e ankueses si të bazuar dhe ka obliguar organin e punësimit që ankueses t'ia harmonizoj koeficientin e pagës me titullin e pozitës dhe përshkrimin e vendit të punës nga gjashtë (6) në tetë (8), ku si rrjedhojë organi i punësimit respektivisht Komuna e Mitrovicës së Jugut, më datë 03.12.2022 ankueses i ka lëshuar Akt Emërimin AE.Nr. 01-112/01-0107816/22 me koeficient tetë (8).

Ankuesja më datë 15.02.2023 ka parashtruar kërkesë tek Kryetari i Komunës së Mitrovicës së Jugut dhe Drejtori i Drejtorisë së Inspektionit për kompensimin retroaktiv të diferencës së koeficientit për periudhën nga data 23.04.2013 kur e ka nënshkruar Akt Emërimin e deri me datë 03.12.2022.

E pakënaqur kundër mos përgjigjes nga organi i punësimit, ankuesja me datë 21.02.2023 parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për kompensimin e mjeteve financiare në mënyrë retroaktive nga data 23.04.2013 kur e ka nënshkruar Akt Emërimin e deri me datë 03.12.2022, konkretisht diferencës së një koeficienti të pagës.

Kolegji i Këshillit, shqyrtoj pretendimin ankimor të ankueses lidhur me kompensimin e diferencës së një koeficienti të pagës në mënyrë retroaktive dhe si rrjedhojë konstatoi se pretendimi ankimor i ankueses si i tillë nuk është i bazuar, sepse sipas shkresave të administruara të lëndës rrjedh se ankuesja me datë 23.04.2013 ka nënshkruar pa vërejtje Aktin e Emërimit për pozitën e punës " Inspektore e Shërbimeve Komunale" me koeficient të pagës tetë

(8), dhe se e njëjta edhe përkundër faktit se ka qenë në dijeni lidhur me koeficientin e përcaktuar të pagës dhe është paguar me koeficientin e pagës gjashtë (6) nuk ka ndërmarr asnjë veprim juridik në kuptim të harmonizimit të koeficientit të pagës me vendin e punës deri me datë 15.02.2023, duke vepruar kështu në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.02/L-28 për Procedurën Administrative (ligj ky i aplikueshëm në kohën kur ankuesja kishte nënshkruar Aktin e Emërimit me datë 23.04.2013), përkatësisht nenin 130 të këtij ligji ku përcaktohej se: 130.1. *Ankimi administrativ bëhet brenda 30 ditësh nga dita kur: a) ankuesi ka marrë njoftim për aktin ose për refuzimin për të nxjerrë aktin.*

Theksuar si më sipër, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur MbiKëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.385/2023

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës

Malsore Gashi Bajraktari

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Mitrovicës së Jugut;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Mitrovicës së Jugut; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së